

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 17.06.2021

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “shkarkim nga detyra” të magjistrates E.S.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor ndaj magjistrates E.S. me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për mosparaqitje në detyrë, me ankesë të drejtuesit të Gjykatës.

Nga hetimi disiplinor rezulton se:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka akorduar magjistrates, më 09.02.2018, leje për shkëputje nga puna për një periudhë 2 vjecare, për arsye shëndetësore. Gjyqtarja nuk është paraqitur në detyrë në përfundim të lejes. KLGJ më 28.10.2020 ka refuzuar kërkesën e saj për dhënie leje shtesë të papaguar. Pas ankesës së magjistrates në Gjykatën Administrative të Apelit, kjo e fundit vendos më 02.02.2021 shfuqizimin e vendimit të KLGJ dhe kthimin e cështjes për rishqyrtim në Këshill. Me 29.03.2021, KLGJ rimori në shqyrtim kërkesën e magjistrates dhe ka vendosur sërish refuzimin e saj. Magjistratja ka marrë dijeni për këtë refuzim të ri të KLGJ më 31.03.2021 dhe vazhdon të mos paraqitet në mënyrë të pajustificuar në detyrë. Gjatë hetimit disiplinor provohet se nga ana e magjistrates nuk është arritur të justifikohet mungesa e saj në punë për shkaqet objektive të pretenduara prej saj. As Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe as Zv. Kryetari i Gjykatës së Apelit nuk kanë dhënë asnjë vendim pozitiv mbi kërkesën e magjistrates për pamundësinë e pretenduar prej saj për të justifikuar mosparaqitjen e saj në detyrë pas datës 01.04.2020, duke sjellë një mosparaqitje në detyrë pa shkaqe të justifikuara prej më tepër se 1 vit.

Nga sa më sipër provohet se nga ana e magjistrates E.S. është kryer shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 102, pika 2, shkronjat “f” dhe “gj”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të cilin parashikohet shprehimisht se: “Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: ...[...]. f) mungesa e pajustificuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit”...[...]. gj) moszbatimi pa shkaqe të justifikuara të vendimeve të dhëna nga Këshilli”.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor të pranojë kërkesën e tij për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates E.S., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1, shkronjat “f” dhe “gj”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe caktimin ndaj gjyqtarës të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.